Edukimi dhe trajnimi i të punësuarve dhe vullnetarëve të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë. Shoqata nationale do të vazhdojë me zbatimin e trajnimeve për resurset njerëzore nëpërmjet projekteve dhe programeve të rregullta të shoqatës nationale. Gjatë vitit do të sigurohen trajnime për mbindërtimin e kapaciteteve të strukturës udhëheqëse dhe drejtuese të organizatës në nivel nacional dhe lokal. Do të zbatohet trajnim për orientim për resurse njerëzore të rizgjedhur udhëheqëse dhe drejtuese të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë.

Implementimi i masave për përparimin e gjendjeve në organizatat komunale të Kryqit të kuq. Në bazë të rezultateve të Vlerësimit të punës së organizatave komunale të Kryqit të kuq dhe Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit zbatuar në vitin 2012, shoqata nationale vazhdimisht do të ndërmerr aktivitete për përparimin e gjendjeve në organizatat komunale ku ekzistojnë nevoja për zbatimin e aktiviteteve të vazhdueshme për mbindërtimin e kapaciteteve të organizatave komunale.



VULLNETARËT SI LIDERË NË PËRFORCIMIN E KAPACITETEVE TË BASHKËSISË LOKALE DHE SHOQËRISË

Një prej mënyrave më të sigura të krijimit apo zbatimit të përkatësisë ndaj bashkësive është që t'i mundësojmë njerëzve të marrin pjesë në aktivitetet të cilat i përforcojnë, ndërsa puna vullnetare është mënyrë e shkëlqyeshme që individi në mënyrë aktive të kyçet në mbindërtimin e saj. Vullnetarët në Kryqin e kuq të Republikës së Maqedonisë veprojnë duke dhënë në disponim të gjitha kapacitetet e veta në kuadër të organizatës nëpërmjet donacionit të kohës, energjisë apo talenteve, me çka edhe i ndihmojnë bashkësës dhe e plotësojnë misionin tonë human.

Përfitimet për vullnetarët reflektohen kah mundësia që të kyçen në aktivitetet për të cilat kanë interes dhe dëshirë, nëpërmjet së cilës përfitohen me informacione të reja, zhvillojnë aftesi të reja apo i përmirësojnë dituritë ekzistuese. Ato formojnë aftesi lidere dhe sociale nëpërmjet komunikimit të vazhdueshëm me grupet e mjeruara qëllimore të popullatës, me bashkëpunëtorët profesional, partnerët, përkrahësit dhe vullnetarët tjerë në Kryqin e kuq të Republikës së Maqedonisë, përderisa vullnetarët të cilët vazhdimisht vazhdojnë t'i zhvillojnë dituritë e tyre, marrin edhe ekspertizë të rëndësishme nga përvaja vullnetare.

Në kuadër të aktivitetit të vet vullnetarët në Kryqin e kuq të Republikës së Maqedonisë shpesh herë janë në rolin e arsimtarëve, edukatorëve, këshilltarëve, mentorëve, shoqëruesve dhe trajnuesve. Organizojnë ngjarje, marrin pjesë në grumbullimin e mjeteve, sigurojnë përkrahje teknike, sigurojnë resurse dhe përkrahje logjistike, implementojnë dhe zhvillojnë programe, organizojnë ngjarje promovuese, si dhe sigurojnë liderë dhe udhëheqje. Nga ana tjetër kontributi i vullnetarëve në bashkësitetë tregojnë kontributin shumë të madh, nëpërmjet shërbimeve të cilat i sigurojnë për individët, familjet dhe bashkësinë me qëllim kënaqjen e nevojave lokale.

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë kontributin e vet programor e drejton kah dëshirat dhe nevojat e vullnetarëve, përshtatur me nevojat e grupeve qëllimore dhe bashkësive, nëpërmjet zhvillimit të kornizës programore për angazhim të vazhdueshëm i cili kyç veprimitari më efektive dhe më efikase.

Puna jonë është e bazuar në përkrahjen e vullnetarëve. Aktivitetet programore në vitin 2014 do të lëvizin në drejtim të përparimit të sistemit për evidencën e aktivitetit vullnetar nëpërmjet futjes së formularëve evidencë në orëve vullnetare, zbatim të qasjes së unifikuar dhe pozitave vullnetare të punës me veprimitari nga të gjitha organizatat komunale të Kryqit të kuq dhe Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit, zbatim të trajnimeve vullnetare në organizatë. Një ndër kontributet më të rëndësishme për vitin vijues është përforcimi i kapaciteteve të vullnetarëve – menaxherëve nëpërmjet organizimit të mbledhjes – punëtorisë koordinuese me detyra konkrete dhe obligime për zbatimin e mjetave të veta personale dhe zbatimin e metodave përvëzhgim.

Personat e angazhuar për menaxhim vullnetar paraqesin konsulantë kyçe të brendshme të cilat i identifikojnë mundësitet për aktivitet, kontribuojnë për zhvillimin e kuadrit vullnetar, projektojnë strategji për integrim efektiv të vullnetarëve, e evaluojnë ndikimin e shërbimit vullnetar për grupet qëllimore dhe për organizatën, dhe janë përfaqësues të të drejtave të vullnetarëve në kuadër të organizatës dhe bashkësës në tërësi. Rëndësia e tyre lidhet me aktivitetin si lidhje e rëndësishme mes nevojave të organizatës dhe grupeve qëllimore.

KONTRIBUT NË PËRMIRËSIMIN E KUALITETIT TË JETESËS SË POPULLATËS SË MJERUAR NË BASHKËSI

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë si ndihmës i Qeverisë, nëpërmjet veprimit të vet kyçet dhe kontribuon në mënyrë partnere të ndikojë në uljen e mjerueshmërisë, si dhe në ç'kyçjen sociale të popullatës.

Për realizimin e aktiviteteve sociale – humanitare të Kryqit të kuq do të zhvillohen lidhje operative me institucionet qeveritare, sektorin qytetar, si dhe biznes sektorin në Maqedoni. Në implementimin e aktiviteteve programore dhe projektuese do të zbatohet qasja participative me involvim të drejtpërdrejtë aktiv të grupeve të mjeruara qëllimore të popullatës me qëllim që të kontribuhet spektër i gjerë i përgjigjeve të mundshme të sfidave të vërtetuara në bashkësi. Sigurim i shërbimit adekuat dhe kualitativ të përdoruesve, përfornimi i kapaciteteve materiale, si dhe mbindërtimi i resurseve njerëzore, do të paraqesin kontribute prioritare të organizatës së Kryqit të kuq. Nëpërmjet implementimit të aktiviteteve Kryqi i kuq do ta promovojë përfaqësimin gjinor dhe do të përkushtojë vëmendje për realizimin e mundësive për kyçje të barabartë të meshkujve dhe grave në punën humanitare.

Aktivitetet tradicionale sociale – humanitare vazhdimisht do të organizohen edhe gjatë vitit 2014 të cilët kontribuojnë kah ulja e mjerueshmërisë së popullatës. Me implementimin e aktiviteteve humanitare sigurohen resurse materiale për veprimtari më efikase të organizatës në kënaqjen e nevojave primare të popullatës së mjeruar. Gjithashtu aktivitetet tradicionale kanë për qëllim ngritjen e vetëdijes publike për kontribut në zgjidhjen e çështjeve nga sfera sociale, aktivitete të cilat do



të zbatohen në bashkëpunim dhe përkrahje të institucioneve qeveritare, sektorit qytetar dhe korporativ.

Zbatimi i pikave për grumbullim, distribuim dhe menaxhim efektiv të veshmbathjeve të përdorura. Për Kryqin e kuq që në kohë të kyçet dhe të japë përkrahje në kënaqjen e nevojave themelore primare për popullatën ballafaquar me një rrezik të caktuar social, shoqata nationale bën orvatje për sigurimin e ndihmës së vazhdueshme materiale. Me qëllim sigurimin më efektiv të ndihmës së donuar nga qytetarët, Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë fut formë të re për grumbullimin e rrobave të përdorura, nëpërmjet vendosjes së kontejnerëve në lokalitete publike, ku qytetarët munden ta donojnë veshmbathjen e tyre në çdo kohë të përshtatshme për ata. Në kuadër të këtij aktiviteti parashikohet hapja e shitores për veshmbathje të përdorur e cila do të jetë e kapshme për popullatën e

mjeruar me qëllim të ruhet integriteti i tyre, si dhe të ruhet dinjiteti i personave të cilët ballafaqohen me rreziqe të caktuara sociale.

Përkatja psiko – sociale e grupeve të mjeruara qëllimore është një ndër prioritetet strategjike të organizatës, me theks të posaçëm në zhvillimin e aktiviteteve për përkrahjen e personave me nevoja të posaçme. Përmirësimi i socializimit të fëmijëve dhe rinisë me nevoja të posaçme është aktivitet i vazhdueshëm që implementohet në bashkëpunim me institucionet qytetare dhe sektorin qytetar e korporativ. I njëjtë do të vazhdojë të realizohet edhe me zgjerimin përbajtjeve të reja të drejtuara kah sigurimi i përkrahjes psiko – sociale të fëmijëve në familje kujdestare.

Zhvillimi i përbashkët i bashkësive – ZHPB paraqet metodë për punë të cilin organizatat komunale të Kryqit të kuq e zbatojnë në implementimin e aktiviteteve për vlerësim të shpejtë të përbashkët të nevojave dhe përkrahje për zgjidhjen e problemeve primare të bashkësive të mjeruara. Me këtë metodë sigurohet përkrahje dhe përforcohen kapacitetet e grupeve të mjeruara qëllimore për integrim më të mirë social në bashkësi. ZHPB si mjet për punë zbatohet nëpërmjet organizatave komunale të Kryqit të kuq, që gjatë vitit parashikohet të zhvillohet dhe zbatohet në or-

ganizata tjera komunale të Kryqit të kuq. Dituritë e hasura nëpërmjet programit ZHPB njëkohësisht do të përdoren për zhvillimin e metodave ekzistuese dhe gjetjen e metodave dhe shërbimeve të reja për të ndihmuar popullatën e mjeruar në bashkësitë lokale.

Lufta kundër tregtisë me njerëz. Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë si anëtar i Sekretariatit të Komisionit nacional përluftë kundër tregtisë me njerëz dhe migrimit ilegal, nëpërmjet implementimit të aktiviteteve preventive jep kontribut aktiv në luftën kundër këtij problemi global që reflektohet edhe në Maqedoni. Gjatë vitit do të implementohen trajnimet edukative për edukim moshatar të vullnetarëve të organizatave komunale të Kryqit të kuq që në



mjetet e veta do t'u bartin njohuritë moshatarëve të tyre nëpërmjet organizimit të punëtorive edukative preventive në shkolla fillore dhe të mesme. Kryqi i kuq në mënyrë aktive do të kyçet edhe në shënimin e Ditës ndërkombëtare dhe Javën përluftë kundër tregtisë me njerëz të cilët janë të koordinuar nga ana e Komisionit nationale përluftë kundër tregtisë me njerëz dhe migracionit ilegal të RM-së. Aktivitetet preventive janë të drejtuara kah ngritura e vetëdijes së popullatës së re për njohjen e mënyrave nëpërmjet të cilave rinia mund të futen në tregtinë me njerëz dhe vetëmbrojtja e tyre.

Preventiva nga keqpërdorimi seksual dhe pedofilia. Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë në bashkëpunim me EP Enti për punë sociale në mënyrë aktive është i kyçur në implementimin e aktiviteteve preventive në kuadër të fushatës "Me edukim dhe dituri deri në preventivë nga keqpërdorimi seksual dhe pedofilia" të cilin e zbaton Ministria për punë dhe politikë sociale.

Qëllimi i fushatës është sensibilizimi dhe ngritura e vetëdijes publike për problemin e keqpërdorimit seksual të fëmijëve dhe pedofilia. Aktivitetet preventive vazhdimesh do të vazhdojnë që të implementohen dhe zhvillohen me forma të reja me qëllim zgjerimin e njohurisë për problemin e keqpërdorimit seksual të fëmijëve dhe pedofilia mes rinisë në institucionet arsimore – edukative.

HAP KAH MËNYRA E SHËNDOSHË DHE BASHKËKOHORE E JETESËS

Programi për punë për vitin 2014, në programin për veprimitari shëndetësore – preventive pranë Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë është krijuar në bazë të prioriteteve, parimeve, Planit strategjik për veprimitari shëndetësore preventive 2011 – 2015, si dhe nevojat reale në teren. Këtë vit, aktivitetet do të drejtohen kah përmirësimi i gjendjes shëndetësore për grupet e mjeruara gjegjësisht për preventivë nga HIV transmisioni mes grupeve më të ndryshme të popullatës, përmirësimi i kontrollit të tuberkulozit në nivel lokal, kujdes shëndetësor për persona të moshuar si dhe ulja e ndikimit të ndryshimeve klimatike mbi shëndetin e njeriut.

Preventiva nga HIV transmisioni mes grupeve më të ndryshme të popullatës në Republikën e Maqedonisë. Nëpërmjet programeve të zbatuara për uljen e pasojave të dëmshme nga përdorimi i lëndëve narkotike në tre qendrat në Veles, Prilep dhe Kërçovë, Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë, si partner i Ministrisë së shëndetësisë vazhdimisht ndërmerr aktivitete në drejtim të mbajtjes së prevalencës së ulët të HIV-it në Republikën e Maqedonisë.

Duke u kujdesur për grupet më të mjeruara të popullatës siç janë përdoruesit intravenoz të lëndëve narkotike, dhe shërbimet shëndetësore, sociale juridike dedikuar për ata, qëndrojmë të japim kontribut në uljen e rrezikut nga HIV/SIDA, hepatit B dhe C, sëmundje bartëse nëpërmjet gjakut dhe infeksione tjera seksuale ngjitime, mbidozimi dhe pasoja tjera shëndetësore dhe dëme sociale, si dhe risocializimi dhe riintegrimi i përdoruesve të lëndëve narkotike në shoqëri.

Përmirësimi i kontrollit të tuberkulozit në nivel lokal. Duke e përdorur metodologjinë "Zhvillim i përbashkët i bashkësive", Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë nëpërmjet organizatave të veta komunale, e në bashkëpunim me vetëqeverisjet lokale adekuate e fasiliton procesin e sjelljes së planeve të qëndrueshme efikase lokale operative për preventivën e tuberkulozit duke theksuar nevojat dhe prioritetet në nivel lokal. Ngritja e vetëdijes dhe diturisë së popullatës për tuberkulozë, posaçërisht duke theksuar grupet më të rrezikuara të popullatës për sëmundje, nëpërmjet realizimit të ligjératave edukative, shpërndarjen e materialit edukativ informativ. Projekti do të realizohet në më shumë qytete në Maqedoni, Vallandovë, Kërçovë, Strugë, Kriva Pallankë, Gostivar, Veles.

Kujdesi dhe përkrahja e personave të moshuar. Kryqi i kuq si anëtar i Trupit nacional koordinues përcjellje dhe evaluim të implementimit të Strategjisë nationale për persona të moshuar kyçet dhe kontribuon në kapshmërinë në resurset, të drejtat dhe shërbimet e nevojshme për pjesëmarrje në shoqërinë e

personave të moshuar.

Me zhvillimin e ekipeve mobile të Kryqit të kuq do të sigurohet shërbim adekuat për kënaqjen e nevojave primare të personave të vëtmuar dhe të moshuar në kushte shtëpiake të cilët janë të ballafaquar me rreziqe të caktuara sociale.

Nëpërmjet projektit "Kujdes për persona të moshuar në kushte shtëpiake", Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë përskaj shërbimeve sociale të cilat i implementon për këtë grup qëllimor, realizon edhe aktivitete mjekësore në drejtim të kujdesit dhe ruajtjes dhe përmirësimit të shëndetit të personave të moshuar si grup i mjeruar i popullatës.

Projekti implementohet në Kryqin e kuq të qytetit të Shkupit, organizatat komunale të Kryqit të kuq Veles dhe Kriva Pallankë. Hapja e qendrave ditore dhe klubeve për persona të moshuar paraqet formë të organizuar për përkrahjen e personave të moshuar që do të zhvillohet në shoqatën nationale në bashkëpunim dhe përkrahje të institucioneve qeveritare dhe pushtetit lokal.

Ulja e ndikimit të ndryshimeve klimatike mbi shëndetin e popullatës. Ndikimet e ndryshimeve klimatike, duke kryçur edhe ndikimet mbi shëndetin e popullatës, mund të ulen apo shmangen nëpërmjet ndërmarrjes së masave për adaptim apo përshtatje. Qëllimi primar i këtyre masave është që të ulet ngarkesa me sëmundje, lëndime, invaliditet, vuajtje dhe vdekshmëria.

Valët e nxeha. Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë në pajtueshmëri dhe planin aksionar për valë të nxeha vazhdon me zbatimin e aktivitetave të drejtura kah mbrojtja e shëndetit të popullatës nga valët e nxeha, si dhe ngritja e vetëdijes publike për pasojat e mundshme nga të njëjtat, si dhe edukimi për masat e mundshme preventive që secili individ mundet dhe duhet t'i ndërmerr me qëllim që ta mbrojë shëndetin e tij dhe shëndetin e më të afërmve.

Valët e ftohta. Në pajtueshmëri me kushtet e motit gjatë periudhës së dimrit, duke marrë parasysh edhe

nevojat e popullatës, Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë është i gatshëm që të reagojë gradualisht me ndërmarrjen e aktiviteteve më të ndryshme për mbrojtje të shëndetit të popullatës nga pasojat të cilat mund të paraqiten si rezultat i shfaqjes së temperaturave të jashtme ekstreme të ulëta duke theksuar grupet më vulnerable të popullatës, si të pastrehuarit, familjet e varfra sociale, personat e moshuar, fëmijët etj.



REDUKTIMI I RREZIQEVE NË FATKEQËSITË E PËRDITSHME NËPËRMJET NDIHMËS SË PARË

Ndihma e parë është një ndër aktivitetet më të njohura të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë me të cilin kontribuohet që individët, familjet dhe bashkësítë me sukses t'i ndalojnë dhe lehtësojnë pasojat nga fatkeqësítë e trafikut, lëndimet dhe sëmundjet.


Edukimi nga fusha e ndihmës së parë është pjesë e rëndësishme e promovimit të aktiviteteve shëndetësore – preventive, dhënia e ndihmës së parë gjatë fatkeqësive të trafikut, trajnim për ndihmë të parë në organizata punuese, për kandidatë për vozitës dhe ndihma e parë për grupe më të ndryshme qëllimore. Shërbimet dhe edukimi nga fusha e ndihmës së parë patjetër duhet të jenë në pajtueshmëri me rregulloret më të reja, me qëllim që të sigurohen standartet e nevojshme në ndihmën e parë.

Qëllimi primar në fushën e ndihmës së parë në vitin 2014 do të jetë përforcimi i kapaciteteve ekzistuese materiale dhe njerëzore në sigurimin e shërbimeve efikase dhe kualitative për grupet e ndryshme qëllimore, si dhe futje të aktiviteteve të reja dhe zhvillimi i atyre ekzistuese dhe përforcimi i bashkëpunimit me partnerë. Këto qël-

lime Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë do t'i realizojë nëpërmjet: zbatimit të kurseve nga ndihma e parë për kandidatë për vozitës, për organizata punuese, për grupe të ndryshme qëllimore (persona të moshuar, bebi – sitere, rini, institucione shtetërore etj.)

Gjithashtu do të zbatohen kurse për edukatorë dhe demonstratorë të rinj të licencuar nga ndihma e parë, kurse freskuese nga ndihma e parë për edukatorë tanimë të licencuar, demonstratorë dhe gjykatës për gara komunale dhe shtetërore, si dhe për grimues dhe manekinë për paraqitje reale të lëndimeve. Gjatë vitit do të organizohen trajnime për persona jo mjekësor për përdorim me defibrilator automatik të jashtëm, do të merret pjesë në trajnime stimuluese për paraqitje reale të lëndimeve që do të organizohen në bashkëpunim me institucione qeveritare. Shoqata jonë nationale gjithashtu do t'i shënojë Ditën botërore nga ndihma e parë, Dita botërore e viktimave nga fatkeqësítë në trafik.

Nëpërmjet aktiviteteve për sigurimin e edukimit kualitativ dhe studiues nga ndihma e parë do të kontribuohet për ndërtimin e bashkësive të sigurta dhe të shëndosha nëpërmjet preventivës dhe reduktimit të rreziqeve në fatkeqësítë e përditshme dhe katastrofat. Me trajnim adekuat dhe efikas për ndihmë të parë, vullnetarët e Kryqit të kuq duhet të kontribuojnë në përmirësimin e rezistencës së individëve dhe bashkësive, në përgatitjen dhe veprimin në jetën e përditshme dhe në rast të katastrofave.



MJAFT DHURUES TË GJAKUT GJITHMONË MJAFT GJAK

Dhurimi i gjakut paraqet përgjegjësi humanitare – sociale ku nëpërmjet dhënies së gjakut dhe përhapjes së idesë për dhurim solidar, vullnetar, anonim dhe pa pagesë të gjakut ndihmohet gjatë shërimit të qytetarëve. Dhurimi i gjakut është e drejtë dhe obligim i qytetarëve, që del nga dispozitat e Ligjit për mbrojtje shëndetësore, me çka qytetarët kanë të drejtë në mbrojtje shëndetësore, duke kyçur edhe shërimin me gjak dhe prodhime gjaku.

Programi për organizim dhe përparrim të dhurimit të gjakut në Republikën e Maqedonisë dhe Ligjin për siguri në furnizimin me gjak, zbatohet nëpërmjet bashkëpunimit të vazhdueshëm dhe të përhershëm gjatë gjithë vitit me Institutin për mjekësi transfuziologjike, si partner në zbatimin e këtij programi në tërësi. Suksesi në realizimin e programit për dhurim të gjakut në masë të madhe varet edhe nga përkrahja dhe bashkëpunimi me Ministrinë e shëndetësisë dhe Fondin për sigurim shëndetësor të Republikës së Maqedonisë. Aksionet e dhurimit të gjakut koordinohen nëpërmjet ekipit për koordinim dhe zbatohen në organizim të organizatave komunale të Kryqit të kuq dhe Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit, Shërbimet rajonale dhe lokale për mjekësi transfuziologjike në pajtueshmëri me Planin vjetor integral për organizim të aksioneve për dhurimin e gjakut në Republikën e Maqedonisë i cili parashev organizimin e reth 950 aksioneve për dhurimin e gjakut në teren që të grumbullohen reth 55.000 njësi gjaku me çka mbulohen nevojat e përgjithshme të sistemit shëndetësor për vitin 2014.

Për nevojat e dhurimit të gjakut në vend, Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë vazhdimesht përgatit materiale shëndetësore – edukative dhe propaganduese, mirënjojje jubilare për dhuruesit e gjakut, zbaton anketa, organizon ligjérata, tribuna dhe fushata me grupe të ndryshme qëllimore, organizon seminare dhe punëtori edukative për edukimin e motivuesve për dhurimin e gjakut, zbaton aktivitete në pajtueshmëri me Strategjinë për dhurimin e gjakut për vitin 2010 – 2015 dhe Politikën për dhurimin e gjakut nga viti 2013, mban evidencë elektronike dhe të shkruar për dhuruesit e gjakut dhe përgatit raporte mujore, periodike dhe vjetore.

Klubi 25 i rinisë do të realizojë aktivitete promovuese për shënimin e ditëve të dhurimit të gjakut, trajnime dhe edukime me rrininë me qëllim që të rritet numri i tyre, me rregull të rekrutohen dhe mbahen në procesin



e dhurimit të gjakut.

Qendra ditore për dhurimin e gjakut vendosur në "Dare Xhambaz" jep kontribut të posaçëm në përparrimin e dhurimit vullnetar të gjakut.

Qendra mundëson njohje te dhuruesit e gjakut për dhurim të gjakut me vet iniciativë dhe për organizimin e një numër më të madh të aktiviteteve promovuese dhe aksioneve për dhurimin e gjakut të cilat do të rriten në tradicionale dhe do të afirmohen në mënyrë adekuate.

Rëndësi të veçantë do të ketë shënim i 17 marsit – Dita e dhurimit të gjakut në Republikën e Maqedonisë dhe 14 korriku – Dita botërore e dhurimit të gjakut, që do të shënohen me aktivitete promovuese dhe solemne, ndarje të shpërblimeve dhe mirënjojje për organizatat komunale më të suksesshme të Kryqit të kuq të cilat e kanë plotësuar planin për dhurimin e gjakut, institucionet, organizatat dhe individët.

VEPRIM I PËRBASHKËT PËR PËRGJIGJE NË KOHË



Në kuadër të plotësimit të tre qëllimeve strategjike nga Strategjia për përgatitje dhe veprim gjatë katastrofave 2012 – 2016, shtrohet nevoja për rritjen e bashkëpunimit me Njësitë e vetëgoverisjes lokale, me çka do të përmirësohej efikasiteti i dhënies së shërbimeve në planin për përgatitje dhe veprim në rast katastrofe.

Në vitin 2014 posaçërisht do të theksohet përparimi i aktiviteteve për përgatitje dhe veprim gjatë katastro-

fave në nivel lokal me qëllim përforcimin e rezistencës së bashkësive në rast të katastrofave, gjendjeve urgjente dhe fatkeqësive. Përskaj punës me organizatat komunale të Kryqit të kuq, do të jepen orvatje të rëndësishme për përforcim plotësues të bashkëpunimit dhe koordinimit mes subjekteve lokale në këtë sferë.

Në planin e përgatitjes dhe veprimit gjatë katastrofave do të organizohen një mori aktivitetesh dhe iniciativa, me qëllim bashkësitetë lokale dhe organizatat komunale të Kryqit të kuq të jenë të gatshme për kënaqje të nevojave në kohë dhe në mënyrë efikase për popullatën lokale në rast të katastrofave apo fatkeqësive.

Në kuadër të aktivitetave me organizatat komunale të Kryqit të kuq, do të kontribuohen orvatje të rëndësishme për trajnim të ekipeve ekzistuese, si dhe formim të ekipeve të reja plotësues komunale për përgjigje gjatë katastrofave, si dhe diseminim i Procedurave standarde operative të Qeverisë së RM-së, ku në mënyrë konkrete janë cekur aktivitetet të cilat duhet t'i ndërmerr shoqata nationale në rast të katastrofave. Përskaj trajnimit, do të theksohet bashkëpunimi dhe koordinimi mes ekipeve nga organizatat e ndryshme komunale me qëllim përmirësimin e operativitetit të tyre.

Për këtë qëllim është paraparë mbajtja e dy trajnimeve dyditore për simulum.

Në vitin 2014 do të fillohet edhe me diseminimin e Politikës së miratuar për përgatitje dhe veprim gjatë katastrofave, si dhe promovimi i Politikës së shoqatës nationale për ruajtjen e rezervave të mallrave nga ndihma humanitare (prodhime ushqimore, higjenike etj.), me qëllim implementimin e tyre në nivel lokal.

Nëpërmjet aktivitetave për uljen e rreziqeve nga katastrofat do të realizohen edukime për të punësuarit në shkollat fillore dhe të mesme në territorin e tre organizatave komunale të Kryqit të kuq, me qëllim që të njihen me procedurat e drejta të cilat duhet të ndërmerrën para, gjatë dhe pas katastrofës dhe të njëjtat t'i përcjellin tek nxënësit.

Në bazë të Rrjetit nacional "Përgjigje klimatike", në kuadër të Forumit të Evropës Juglindore për adaptim në ndryshimet klimatike, bashkëpunimi i suksesshëm i organizatave të ndryshme joqeveritare do të vazhdojë edhe vitin tjetër nëpërmjet zbatimit të aktivitetave edukative për adaptim në ndryshimet klimatike.

Në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar, në vitin 2014 do të mbahet trajnim për ujë dhe sanim në bashkëpunim me Kryqin e kuq të qytetit Shtaer, që do

të ketë për qëllim të freskohen dituritë dhe aftësitetë e vullnetarëve tanimë të trajnuar, si dhe zbatimi i trajnimit fillestar për vullnetarë të rinj. Vend të rëndësishëm do të jepet edhe në pjesën për sanitacion dhe promovim të higjenës, në pajtueshmëri me politikën e Federatës ndërkombëtare të KK dhe GJHK për ujë dhe sanim dhe mjetet dhe standartet adekuate ndërkombëtare të cilat do të përdoren nëpër botë.

Vazhdimesh do të vazhdojë bashkëpunimi me subjektet shtetërore, gjegjësisht me Qendrën për menaxhim me kriza, Drejtorinë për mbrojtje dhe shpëtim, Ministritë për punë të brendshme dhe mbrojtje etj. Është paraparë edhe përforcim i rëndësishëm i bashkëpunimit me Akademinë ushtarake "Gjeneral Mihaillo Apostollski" me karakter edukativ, ku kadetët dhe studentët marrin njohuri plotësuese për rolin e Kryqit të kuq gjatë katastrofave natyrore, por edhe në rajone në konflikt.

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë në pjesën e sigurisë në ujë, aktivitete do të theksojë edhe në përforcimin e kapacitetave të Qendrave për siguri në ujë në Ohër dhe Shkup, me prioritet në planifikimin dhe zbatimin e aktivitetave në pjesën e shpëtimit në ujë, trajnim të shpëtimtarëve, edukim dhe përsosje profesionale në shpëtimin në ujë, kontroll të aftësive psikofizike dhe funksionale të shpëtimtarëve në ujë, punës profesionale – këshilluese dhe profesionale – informative, planifikim të programeve dhe projekteve për vërtetimin e qëndrimeve doktrinare në edukimin e shpëtimtarëve, dokumentim të letërsisë profesionale, krijim, planifikim dhe organizim të fushatave dhe aksioneve propaganduese, marrëdhënie me publikun dhe kontakt me mjetet e informimit publik në pjesën e sigurisë në ujë.

REALIZIMI I LIDHJEVE FAMILJARE

Komponentet e ndryshme të Lëvizjes së Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe me dekada bëjnë orvatje të jashtëzakonshme për zbatimin apo realizimin e lidhjeve familjare. Duke potencuar përvojën dhe vazhdimesinë e aktivitetave të Shërbimit për kërkim të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë, është e pranishme vetëdija dhe vullneti për qasje të mëtutjeshme strategjike dhe zhvillim i kapacitetave personale dhe marrëdhënie me partnerë. Mbindërtimi i kapacitetave në të gjitha nivelet e veprimit të Shërbimit për kërkim, është që të arrihet përgjigje efektive dhe e mjaftueshme e nevojave humanitare të popullatës për realizimin e lidhjeve familjare.

Në kuadër të planit për trajnim në rast të katastrofave të shoqatës nationale, në plan është realizimi i punëtorive trajnuese për freskimin e njohurive të vullnetarëve të trajnuar dhe të punësuarve profesionale në organizatat komunale të KK për punë në Shërbimin për kërkim.

Për shkak të përparimit të programeve në kuadër të shoqatave nacionale, në bashkëpunim me Komitetin ndërkombëtar të KK do të sigurohet prania e mbledhjeve ndërkombëtare të Shërbimeve për kërkim. Ndërtimi i marrëdhënieve adekuate me Qeverinë dhe institucionet qeveritare – ministritë për realizimin e obligimeve informative në rast të nevojës nga zbatimi i lidhjeve familjare do të ngelet prioritet i programit.

EDUKIMI PËR VEPRIMTARI HUMANITARE

Informimi publik dhe përhapja e diturive për Lëvizjen ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, parimet themelore, emblema, E Drejta ndërkombëtare Humanitare (DNH) dhe vlerat humane tek opinioni më i gjërë paraqet kontributin themelor të programit për diseminim të shoqatës nationale.

Edukimi adekuat nxit zbatimin praktik të vlerave universale – paqe, tolerancë, mo dhunë, dialog, vlerat humane – akti dhe aksioni humanitar, kultura e dialogut për kuptim reciprok dhe tolerancë, njojuri aktive dhe raport aktiv ndaj jetës, vlerat humanitare – juridike – raporti humanitar pa diskriminim, dallimi, kufizimi dhe promovimi i vlerave pozitive të veprimit në bashkësi nëpërmjet parimeve të arsimimit humanitar që kryesisht fokusohet në qasje adekuate metodologjike për diseminim.

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë në këtë fushë të veprimit ka ndërtuar strukturë të specializuar e cila mundëson që të ngrihet vetëdija në pjesë të ndryshme të shoqatës nationale nëpërmjet rrjetit personal të organizatave komunale rjonale, vullnetarëve dhe diseminatorëve të specializuar të cilët organizojnë punëtori, sesione, seminare në të gjitha fushat e arsimit humanitar. Një numër i madh i punëtorive, trajnimeve, kurseve, seminareve dhe ekspozitave organizohen në nivel rajonal dhe nacional që të kapet nga grupet e ndryshme qëllimore të popullatës me specifika të ndryshme gjeografike, etnike dhe të moshave të ndryshme të popullatës, nxënës, arsimtarë, punëtorë social, mjekë, ushtarë, politikanë, përfaqësues të rretheve akademike, studentë, të rinj, organizata pune, media etj.

Përparimi i programit për diseminim në vitin programor do të lëvizë kah promovimi i arsimit humanitar si qasje e Lëvizjes që paraqet platformë arsimore për edukim humanitar që zbatohet me qëllim sublimimin e të gjitha programeve të cilat mundësojnë kyçjen e njerëzve të rinj dhe grupeve të tjera qëllimore për t'i analizuar ngjarjet dhe dukuritë e perspektivës humanitare, mobilizon aksion humanitar në shpirtin e Lëvizjes së KK dhe GJHK, parimet themelore dhe vlerat humanitare dhe e kyç vëzhgimin dhe studimin e rregullave elementare të të Drejtës ndërkombëtare humanitare dhe trupat tjerë relevant të të drejtës.

Në vitin 2014 do të punohet kah zbatimi i dis-

eminimit si formë e edukimit në kuadër të të gjitha programeve të KK, modernizimi i mjeteve dhe materialeve punuese, organizim të 180 sesioneve për diseminim me grupe të ndryshme qëllimore nëpërmjet të gjitha organizatat komunale të KK dhe KK të qytetit të Shkupit. Njësoj nëpërmjet zbatimit të dy trajnimeve për diseminatorë të rinj në pjesën e DNH dhe implementimin e aktiviteteve për promovimin e tij mes grupeve specifike qëllimore, si dhe aktivizimi i Klubit për DNH do të kontribuojë kah përparimi i diturive dhe ngritura e vetëdijes për mbrojtje dhe respektim të të drejtave të DNH.

Nëpërmjet arsimit formal dhe joformal, servili vullnetar, përforcimi i rezistencës në bashkësi, dialogu integrues dhe qasja inkluzive pritet që të ndikojë kah ndryshimi i shprehive ndaj qasjes në aksionin humanitar dhe kah stimulimi i zbatimit praktik i parimeve themelore të Lëvizjes në bashkësi.

ZBATIMI PRAKTIK I PARIMEVE THEMELORE

Si mjet më efektiv për tërheqjen e vullnetarëve të rinj, edukimi i tyre, nxitja për realizim dhe implementimi i drejtpërdrejtë i aksionit humanitar në teren për të ndihmuar popullatën e mjeruar dhe në vitin vijues programi Kryqi i kuq në Aksion – Promovimi i vlerave humane (KK – PVH) do ta zgjerojë dhe implementojë edukimin dhe aksionin humanitar. Programi si mjet nacional për tërheqjen dhe mbajtjen e vullnetarëve në radhët e Kryqit të kuq në të gjithë shtetin në nivel vjetor do të kyçë trajnimin e rreth 1200 të rinjve, nga përkatësi të ndryshme etnike dhe prejardhje të ndryshme sociale të moshës prej 14 deri 18 vjet.

Nëpërmjet trajnimit të unifikuar për vlerat e Kryqit të kuq për nevojat e grupeve qëllimore dhe mundësitet për ndihmë dhe përkrahje në periudhën prej 4 muajve rinia do të përpunojnë projekte të vogla humanitare me temë: "Njohja e dallimeve". Nëpërmjet temës iu jepet mundësia që të punojnë për të gjithë dhe me të gjithë (pleq, të rinj, të pastrehuar, persona me hendiķep, grupe të marginalizuara, etnikume të ndryshme etj.). përfaqësuesit e projekteve më të mira edhe më tej do të marrin pjesë në punëtoritë përfundimtare ku mes veti njoftohen dhe marrin njohuri të thelluara për kulturën si sistem i vlerave.

Nëpërmjet programit e promovojmë kulturën e dialogut si bazë për ndërtimin e shoqërisë interkulturore, ku ka respektim dhe interaksion mes kulturave të

ndryshme. Pastaj vijon shënimi i javës së "Promovimi i vlerave humane", prej 21 deri 27 shtator nga ana e të gjithë vullnetarëve të rinj dhe më të vjetër që kyç realizimin e përmbajtjeve kreative. Nëpërmjet trajnimeve të shumta në të gjitha organizatat komunale të KK dhe KK të qytetit të Shkupit, programi KKA-PVH i nxit të rinjtë ta ndërojnë rutinën ditore, të mësojnë për kulturën personale dhe për kulturën e të tjera e dëshironi që t'i ndihmojnë grupeve të mjeruara në bashkësi duke i kyçur edhe vetë ata. Programi KKA-PVH në kuadër të Federatës ndërkombëtare të KK dhe GJH është i njohur si një prej mjeteve adekuate për edukim humanitar në Lëvizje.



RINIA SI PROMOVUESE E NDRYSHIMEVE POZITIVE

Në Kryqin e kuq, rinia karakterizohen si novatorë, përshtatës në komunikim me grupe të ndryshme qëllimore, media dhe teknologji tjera, ata janë ambasadorë inter – kulturorë, edukatorë moshatar, agjentë për ndryshimin e sjelljes dhe përfaqësues të kategorive të mjeruara të popullatës. Tek rinia e KK njihet roli lider në menaxhimin me çështjet bashkëkohore. Me të gjitha këto karakteristika rinia e KK me të drejtë janë të kyçur në të gjitha aktivitetet e shoqatës nationale, në mënyrë relevante dhe specifike për moshën aftësi dhe përvoja të nevojshme.

Vullnetarët në Kryqin e kuq ballafaqohen me sfidat bashkëkohore me të cilat ballafaqohet çdo shoqëri, e në të bëjnë pjesë: varfëria, dhuna, eksplotimi, diskrimini, keqpërdorimi i substancave, fatkeqësitetë dhe sëmundjet, papunësia, tregtia me njerëz, migracionet dhe urbanizimi. E gjithë kjo kontribuon që vullnetarët e KK të paraqesin fuqinë e lëvizjes së kësaj shoqate nationale, burimin e inspirimit dhe përgjegjësi në shoqëri. Ata janë të kyçur në aktivitetet e larta motivuese dhe ndikuese që kontribuojnë në ndërtimin e kësaj shoqate të fortë nationale.

Viti 2014 paraqet vit zgjedhor në strukturën e të rinjve të Kryqit të kuq. Rinia në nivel lokal dhe nacional do të zgjedhin përfaqësuesit e tyre të cilët do t'i udhëheqin në mandatin e periudhës vijuese dyvjeçare. Për personat e rinj të zgjedhur në periudhën e verës do të ketë trajnim për liderë, zëvendës të liderëve dhe përfaqësues në Këshillin e të rinjve të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë, për hasjen e diturive dhe aftësive plotësuese për udhëheqjen e klubeve të të rinjve.

Programet për edukim moshatar për shëndet sekual dhe reproduktiv, preventivë nga tregtia me njerëz,

dhurim vullnetar të gjakut, organizim të garave nga ndihma e parë, iniciimi i themelimit të ekipeve për përgjigje gjatë katastrofave, janë vetëm një pjesë e programeve të cilat do të implementohen gjatë vitit 2014.

Programi KKA-PVH edhe më tej mbetet mjet udhëheqës për rekrutimin dhe motivimin e vullnetarëve të rinj dhe promovimi i implemtimit i tij paraqesin një ndër prioritetet e mëdha në punën e të rinjve.

Si anëtar aktiv i Këshillit nacional të të rinjve të Republikës së Maqedonisë, por edhe si organizatë e cila në përcaktimet strategjike kontribuon për përhapjen e partneriteteve dhe rrjetëzimin me organizata të cilat punojnë për mirëqenien e bashkësive, rinia do të vazhdojnë të ndërtojnë relacione për iniciativa të përbashkëta për më shume shërbime dhe më kualitative të cilat ata mund t'u jasin grupave të mjeruara të popullatës.

Rrjetëzimi dhe ripërtërimi i bashkëpunimit me shoqata tjera nationale posaçërisht do të theksohet gjatë pjesëmarres në Mbledhjen rimore evropiane për bashkëpunim që do të mbahet në Itali gjatë muajit maj.



BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR

Nëpërmjet zbatimit të aktiviteteve të veta për ndihmë dhe përkrahje për grupet e ndryshme qëllimore Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë, ndërton imazhin e vet njohës në Republikën e Maqedonisë dhe në botë. Për këtë qëllim organizata bën orvatje të vazhdueshme për sigurimin e përkrahjes programore ndërkombëtare për të implementuar aktivitetet e shoqatës nacionale. Nëpërmjet punës inovative, transparente dhe efikase shoqata nacionale, si anëtare e Lëvizjes ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe GJHK kujdeset për marrëdhënie me partnerë, siguron fonde dhe këmbejn përvoja me shumë shoqata nacionale të KK dhe GJHK, Federatën ndërkombëtare të KK dhe GJHK dhe Komitetin ndërkombëtar të KK.

Bashkëpunimi i frytshëm realizohet edhe me agjencitë e Kombeve të bashkuara, Bashkimit evropian dhe organizata tjera ndërkombëtare. Në periudhën e kaluar Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë u rrit në shoqatë të fortë nacionale dhe iniciativat, projektit dhe programet të cilat implementohen në vendintonë janë mjet i përhershëm i interesit në kuadër të Lëvizjes dhe në organizata tjera si shembuj për përvoja

dhe arritje pozitive të cilat futen në punën e shumë shoqatave nacionale në rajon dhe më gjërë. Kryqi i kuq i RM-së vazhdimesht siguron përkrahje kadrorike dhe profesionale me vullnetarët dhe të punësuarit e vet për më shumë shoqata nacionale dhe organizata tjera, të cilët i bartin dituritë, aftësitë dhe përvojat e veta nga lëmi më të ndryshme në vende tjera të botës.

Rezultatet e mira dhe besimi i cili është hasur para organizatave partnere duhet të kontribuojnë që KKRM-së në vitin 2014 të sigurojë përkrahje për implementimin e projekteve dhe programeve të finançuara nga donatorë ndërkombëtarë dedikuar për mbindërtimin e kapaciteteve dhe për mbulimin e nevojave të kategorive të mjeruara të popullatës në Republikën e Maqedonisë.

Bashkëpunimi bilateral i Kryqit të kuq të RM-së në nivel nacional dhe lokal vazhdimesht zgjerohet me më shumë shoqata nacionale të KK dhe GJHK që mundëson këmbim të rregullt të përvojave të organizuara, material informativ dhe ndihmë profesionale në drejtim të përmirësimit të kualitetit të shërbimeve të popullatës së mjeruar.

Përbajtjet programore dhe projektuese të cilat do të implementohen me përkrahje ndërkombëtare janë pjesë integrale e veprimitarive të prezantuara programore në këtë dokument.



IMAZHI DHE METODAT BASHKËKOHORE TË KOMUNIKIMIT

Marrëdhëniet me publikun janë pjesë e aktiviteteve të përgjithshme të organizatës për përparimin e imazhit dhe dinjitetit të KKRM-së. Me imazhin pozitiv arrihet kredibilitet, i cili do të mundësojë ndërtimin dhe mirëmbajtjen e marrëdhënieve pozitive me bashkëpunëtorët më të ndryshëm, institucionet, partnerët dhe donatorët.

Duke e ditur funksionin dhe nevojën e informimit në punën e përgjithshme, KKRM-së do të japë kontribut aktiv për zbatimin dhe mbajtjen e sistemit efektiv për komunikim dhe informim me qëllim për bashkëpunim më të afërt me mjetet për informim publik. Për punë të suksesshme gjatë vitit 2014 shoqata nationale do të ndërmarrë një mori aktivitetesh për përmirësimin e komunikimit dhe përparimin e marrëdhënieve me publikun. Obligim i yn është që të jemi transparent dhe përgjegjës në punë, përderisa sfidë paraqesin mjetet nëpërmjet të cilave promovohemi ne.

Ueb faqja e Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë e cila vazhdimesht do të mbindërtohet do të mundësojë hapësirë për shpalljen e një numri të madh të informacioneve të llojillojshme, struktura e së cilës ka për qëllim kategoritë e ndryshme qëllimore të vizitorëve. Kryqi i kuq i RM-së me qëllim komunikim të suksesshëm me publikun online, do të ndërmerr qasje integrative dhe bashkëpunuese për praktikumin e rrjeteve sociale.

Botimet javore të gazetës elektronike të Kryqit të kuq INFO do të janë shembull i mjetit të suksesshëm të vullnetarëve tanë, partnerëve, bashkëpunotërve dhe përkrahësve për aktivitetet të cilat i realizojmë në nivel lokal, nacional dhe ndërkombëtar. E – gazeta edhe më tej do të botohet dy herë në javë dhe gjatë vitit 2014 parashihet botimi i saj në rreth 100 numra.

Materialet promovues të cilat janë të definuara në Ligjin për Kryqin e kuq, e që janë edhe nevojë e një numri të madh të aktiviteteve dhe dokumenteve strategjike në kuadër të veprimtarisë botuese të shoqatës nationale edhe këtë vit rregullisht do të përpunoohen me përbajtje kreative dhe atraktive – edukative. Në bashkëpunim me Postën e Maqedonisë do të botohen edhe pulla postare me përbajtje lidhur me kalendarin tradicional të Kryqit të kuq të RM-së.

Organizimi i rregullt i pres konferencës dhe briefingjet për gazetarë do të kenë për qëllim ta afrojnë

organizatën tek mediumet dhe në kohë të sigurohen lajmet në mediume për aktivitetet programore dhe projektuese.

Marrëdhëniet me mediumet dhe trajnimet specifike për gazetarë do të vazhdojnë në drejtim të diseminimit të aktiviteteve të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë në mediumet dhe sigurimi i përkrahjes mediale për aktivitetet tona. Këtë vit me trajnim do të përfshihen 20 gazetarë të mediumeve elektronike dhe të shkruara.



PARTNERITETE TË PËRFORCUARA PËR PËRMIRËSIMIN E JETËS NË BASHKËSI

Në drejtim të sigurimit të shërbimeve më kualitative për popullatën e mjeruar dhe përfunkcionim pa pengesë dhe efikas i shoqatës nationale ndërmerren aktivitete dhe iniciativa përmirësimin e mëtutjeshëm të stabilitetit financiar të organizatës. Për këtë qëllim bëhen orvatje në drejtimin e aktiviteteve të KKRM-së kah qasjet bashkëkohore përsigurimin e fondeve.

Bashkëpunimi me sektorin korporativ dhe zbatimi i partneritetevë strategjike me kompanitë janë një ndër burimet më të rëndësishme përsigurimin e resurseve përkrahjen e projekteve dhe aktivitetevë programore të KK. Me realizimin e më shumë projekteve KKRM-së kontribuoi në nxitjen e përgjegjësisë shoqërore të kompanive përkrahjen përmirësimin e jetës në bashkësi. Për këtë qëllim nepërmjet aktivitetevë adekuate edhe më tej do të bëhen përpjekje në përforcimin e vetëdijes tek kompanitë përsigurimin e përkrahjes efikase dhe përfaqësimin e interesave të popullatës së mjeruar, si vërtetim përgjegjësinë e tyre sociale.

Gjatë vitit në vijim posaçërisht do të theksohet përpunimi i projekteve për aplikim në Fondet paraqasëse të BE, si një prej mundësive më të rëndësishme të burimit përkrahjen e implemetnimit të aktivitetevë të Kryqit të kuq.

Përforcimi dhe zbatimi i bashkëpunimit partneror me sektorin korporativ. Bashkëpunimi partneror me kompanitë është një ndër qëllimet strategjike të Kryqit të kuq të RM-së përmobilizimin e fondeve të sektorit korporativ. Promovimi i përmbajtjeve projektuese para kompanive, e njëkohësisht edhe duke potencuar përfitimet nga partneriteti me Kryqin e kuq, është një ndër format më të rëndësishme përkrahje dhe mundësi përzbatimin e bashkëpunimit partneror në implemetimin e aktivitetevë të Kryqit të kuq. Gjatë vitit do të organizohen takime dhe do të realizohen kontakte të vazhdueshme me kompanitë përkrahjen e iniciativave të përbashkëta, aktivitetevë projektuese dhe programore.


Bashkëpunimi me tre Odat ekonomike në Maqedoni. Gjatë vitit do të realizohet bashkëpunimi i realizuar mirë me Odën ekonomike të RM-së, Lidhjen e odave ekonomike të RM-së dhe Odën ekonomike të Maqe-

donisë veriperëndimore me qëllim implementimin e iniciativave të përbashkëta të definuara në memorandumet e nënshkruara për bashkëpunim në drejtim të promovimit të përgjegjësisë korporative shoqërore të kompanive përkrahjen e tyre në realizimin e grupave të mjeruara qëllimore të popullatës.

Mbledhje partnerore. Për nxitjen e vlerave humane dhe kapacitetevë të Kryqit të kuq të RM-së dhe nxitja e partneritetevë strategjike për implementimin e programeve të përbashkëta sociale të dobishme do të organizohet mbledhje me partnerë me përfaqësues të institucioneve qeveritare dhe sektorin korporativ. Për këtë qëllim do të përgatitet katalog i ri i projekteve përvitin 2014 të cilin Kryqi i kuq i RM-së do t'ua ofrojë partnerëve përkrahjen dhe kryçjen e tyre në implemetimin e përmbajtjeve projektuese.

Përforcimi i kapacitetevë të shoqatës nationale përmobilizimin e fondeve. Gjatë vitit në kuadër të planeve të organizatës përvillimin e kapacitetevë të shoqatës nationale do të organizohen trajnime përvillnetarë dhe të punësuar në organizatat kommunale të Kryqit të kuq përvillimin e aftësive dhe diturive përmobilizimin e fondeve.

Ndarja e mirënjojve të Kryqit të kuq përbashkëpunim dhe përkrahje partnerore. Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë në shenjë falënderimi përbashkëpunimin dhe përkrahjen në realizimin e qëllimeve humanitare të KK partnerëve të vet të sektorit korporativ do t'u ndajë mirënjojje adekuate, kompanitë cilat e praktikojnë punën e përgjegjëse si pjesë përbërëse e politikës afariste.





PUNA FINANCIARE MATERIALE

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë të hyrat dhe të dalurat vjetore, i paraqet qartë në buxhet, i cili mundëson konstruimin e modelit të financimit të organizatës dhe paraqet mundësi për zbatimin e strategjisë, ngjarjes dhe planit të caktuar.

Buxheti i përgjithshëm për vitin 2014 është zvogëluar për 10,23% në krahasim me Buxhetin e viti të kaluar dhe për 19,53% në krahasim me buxhetin e viti 2012. Zvogëlimi ka të bëjë me zvogëlimin e të hyrave nga projektit e siguruara nga donatorë të jashtëm, të hyra të zvogëluara nga Programi përparrimin e dhurimit të gjakut për vitin 2014. Nga të hyrat e përgjithshme, të hyrat e personale të planifikuara këtë vit marrin pjesë me 40,72% dhe shënojnë trend të rritjes në krahasim me vitin e kaluar ku të njëjtat ishin të përfaqësuara me 30,75%, ndërsa të hyrat nga organet dhe donatorët marrin pjesë me 59,28%.

Në pjesën e të dalurave, të dalurat kapitale marrin pjesë me 1,18%, ndërsa të dalurat vijuese janë 98,82% nga të dalurat e përgjithshme. Edhe këtë vit politika e organizatës është e drejtuar kah zhvillimi i organizatave komunale të Kryqit të kuq për çka parashihen mjete të caktuara përkrahjen përvillimin dhe punën rrjedhëse të organizatave komunale të KK të cilat paraprakisht do të zgjidhen në bazë të kritereve të caktuara. Nga të dalurat e përgjithshme në Buxhetin për vitin 2014, 40,57% kanë të bëjnë me shpenzimet e qendrës së KKRM-së, përderisa 59,43% nga Buxheti i përgjithshëm janë të dedikuara për organizatat komunale të KK. Gjithashtu me rëndësi është të përmendet se nga shpenzimet e përgjithshme të zyrës qendrore, 43,42% janë transfero të drejtpërdrejta në organizatat komunale të Kryqit të kuq për realizimin e aktivitetave programore dhe shënojnë rritje në krahasim me vitin e kaluar.

Si shpenzime i zyrës qendrore të KKRM-së janë përfshirë shpenzimet përrrogat e të punësuarve, shpenzimet materiale, si dhe shpenzimet përmirësimi të vazhdueshme. Në pjesën e shpenzimeve të dedikuara për organizatat komunale të KK janë përfshirë shpenzimet për projekte të siguruara nga donatorë apo për programe të siguruara nga institucione.

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë nëpërmjet përcjelljes së trendeve moderne përmodernizimin dhe përsosjen e punës materiale financiare, mundëson transparencë dhe llogaridhënie në punë, përpunim automatik të të dhënavëve, rrjedhje të shpejtë të informacioneve dhe treguesve financiar, bazë të saktë dhe gjithëpërfshirëse të të dhënavëve financiare dhe rritje të kapaciteteve të shoqatës nationale.

Buxheti i Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë është real, gjithëpërfshirës, i strukturuar, preciz dhe i balancuar, përderisa mjetet e planifikura në Buxhetin për vitin 2014, Kryqi i Republikës së Maqedonisë do t'i përdorë në mënyrë të dedikuar, racionale dhe ekonomike, me transparencë dhe llogaridhënie të plotë.

BUXHETI I KRYQIT TË KUQ TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË PER VITIN 2014

	%	2014	2013	2012
Të hyra të përgjithshme	100.00	43,353,105.00	48,296,830.00	53,880,435.50
Burime personale	40.72	17,655,100.00	14,851,500.00	9,154,000.00
Nga organe dhe donatorë		25,698,005.00	33,445,330.00	44,726,435.50
Të dalura të përgjithshme	100.00	43,353,105.00	48,296,830.00	53,880,435.50
Të dalura vijuese	98.82	42,843,105.00	47,996,830.00	53,600,435.50
Të dalura kapitale		510,000.00	300,000.00	280,000.00
Dallimi	100.00	0.00	0.00	0.00

TË HYRA

PËRSHKRIM	Burime personale të të hyrave	Të hyra nga organe / donatorë	Buxheti 2014	Buxheti 2013	Buxheti 2012
TRANSFERE DHE DONACIONE					
"Ministria e Financave (Nga Buxheti i RM-së - mjete për aktivitetet programore)"	6,000,000.00		6,000,000.00	6,200,000.00	6,324,000.00
Dhurimi i gjakut (Ministria e shëndetësisë)		6,763,000.00	6,763,000.00	7,000,000.00	10,000,000.00
Veprimtari sociale - humanitare	300,000.00		300,000.00	2,300,000.00	300,000.00
Organizim dhe zhvillim			0.00	3,100,000.00	347,000.00
Ndihma e parë	3,000,000.00		3,000,000.00	2,350,000.00	2,900,000.00
